



Këshilli i Mediave të Shkruara të Kosovës  
Press Council of Kosovo  
Savet Štampe Kosova

18.05.2020, Prishtinë,  
Ref:21.02.2020\907-2020

**Vendim i Këshillit të Mediave të Shkruara të Kosovës ndaj  
ankesës së Administratës Tatimore të Kosovës kundër gazetës  
online Insajderi**

Këshilli i Mediave të Shkruara të Kosovës në mbledhjen e tij online të mbajtur më 8 maj 2020, shqyrtoi ankesën e Administratës Tatimore të Kosovës kundër gazetës online Insajderi lidhur me artikullin: *"Skandal në ATK – kompania që kishte transaksione fiktive fitoi tenderin 10 milionësh"*, dhe mori këtë:

V E N D I M

- Ankesa miratohet pjesërisht.

## A R S Y E T I M I

Ankesa ka të bëjë me pretendimin se gazeta online Insajderi ka keqinformuar publikun me artikullin që ka botuar, si dhe më pas nuk e ka botuar reagimin e Administratës Tatimore të Kosovës, me çka është shkelur gjithashtu Kreu IV (E drejta për t'u përgjigjur) i Kodit të mediave.

Lajmi është i shkruar në portal dhe objekt i kësaj ankese është mos botimi i reagimit, e që rrjedhimisht ankesa është e lejueshme për trajtim dhe e afatshme.

Pas leximit të ankesës KMSHK gjen se ankesa është pjesërisht e bazuar. Për shkak se ankuesi paraqet ankesë në lidhje me mos botimin e demantit apo reagimit nga Administrata Tatimore e Kosovës, për shkrimin "Skandal në ATK - kompania që kishte transaksione fiktive fiton tenderin 10 milionësh".

Menjëherë pas shkrimit, ATK kishte paraqitur një reagim kundër gazetës Insajderi, për të cilin reagim gazeta nuk e kishte botuar përkundër se ka qenë e obliguar që ta bënte sipas Kreut IV (E drejta për t'u përgjigjur).

KMSHK pas shqyrtimit të ankesës, vëren se ankesa është e bazuar, meqë gazeta nuk ka publikuar askund reagimin e ATK-së në lidhje me shkrimin e saj.

KMSHK pas analizimit të provave të dorëzuara dhe shkrimit të botuar, vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Këshilli i Mediave të Shkruara të Kosovës**